



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:149892
Datë: 07.03.2023
Numri i dokumentit: 04054257

PA1.nr.76/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti i Përgjithshëm – kolegji i përbërë nga gjyqtarët Abdullah Ahmeti – kryetar i kolegjit, Ferit Osmani dhe Zyhdi Haziri - anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e praktikantes gjyqësore Anila Haklaj, në çështjen penale ndaj të akuzuarve S.P dhe M.S, që të dy me vendbanim në D. të M. së V., për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Shantazhi nga neni 329 par. 2 lidhur me par. 1 dhe lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së), duke vendosur sipas ankesës së Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan, ankesës së përfaqësuesit të autorizuar të dëmtuarit M.S – av. I.R, ankesën e mbrojtësit të të akuzuarit S.P – av. B.D dhe ankesën e mbrojtësit të të akuzuarës M.S – av. B.M, të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, P.nr.755/2022, datë 07.12.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur konform nenit 390 të KPPK-së më datë 23.02.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. Me **aprovimin** e ankesës së Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan, **ndryshohet** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, P.nr.755/2022, datë 07.12.2022, ashtu që Gjykata e Apelit e Kosovës të akuzuarve S.P dhe M.S, për veprën penale në bashkëkryerje Shantazhi nga neni 329 par. 2 lidhur me par. 1 dhe lidhur me nenin 31 të KPRK-së iu shqipton dënime me burgim në kohëzgjatje prej nga 3 (tre) vite e 6 (gjashtë) muajve secilit veç e veç. Koha e kaluar në paraburgim nga data 22.07.2022 e tutje iu llogaritet në dënimet e shqiptuara. Aktgjykimi i ankimuar përkitazi me pjesën e dënimit me gjobë dhe mënyrën e zëvendësimit të të njëjtit si dhe në pjesët e tjera ngelë i pandryshuar.

- II. **Refuzohen** si të pabazuara ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit S.P – av. B.D dhe ankesa e mbrojtësit të të akuzuarës M.S – av. B.M, të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, P.nr.755/2022, datë 07.12.2022.
- III. **Hudhet** si e palejuar ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të dëmtuarit M.S – av. I.R e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, P.nr.755/2022, datë 07.12.2022.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjilan, me aktgjykimin P.nr.755/2022, datë 07.12.2022, të akuzuarit S.P dhe M.S i ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Shantazhi nga neni 329 par. 2 lidhur me par.1 dhe lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe i ka gjykuar të akuzuarin S.P me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve dhe me dënim me gjobë në shumë prej 600 (gjashtëqind) euro të cilat dënime do të ekzekutohen në afat prej 15 ditësh pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, të akuzuarën M.S me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 4 (katër) muaj dhe me dënim me gjobë në shumë prej 400 (katërqind) euro, të cilat dënime do të ekzekutohen në afat prej 15 ditësh pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë. Nëse të akuzuarit nuk dëshirojnë ose nuk mund të paguajnë dënimin me gjobë atëherë i njëjti do të u zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20 (njëzet) euro do të i caktohet 1 (një) ditë burgim. I dëmtuari M.S për realizimin e kërkesës pasurore – juridike është udhëzuar në kontest të rregullt juridiko – civil. Të akuzuarve iu është konfiskuar telefonat mobil Samsung me ngjyrë të zezë me 35405/62/865723/1 dhe Iphone “12Pro Max” me ngjyrë ari me IMEI të panjohur. Të akuzuarve S.P dhe M.S pas shpalljes së aktgjykimit P.nr.755/22, i vazhdohet paraburgimi me aktvendim të veçantë deri kur ky aktgjykim të marrë formën e prerë, por jo më gjatë se koha e dënimit të shqiptuar me aktgjykimin e kësaj gjykate. Në bazë të nenit 79 par. 1 të KPRK-së, koha e kaluar në paraburgim nga data 22.07.2022, deri kur ky aktgjykim të merr formën e prerë, do të iu llogaritet në dënimin me burgim. Janë obliguar të akuzuarit e lartëcekur që secili prej tyre veç e veç të paguajnë paushallin gjyqësor në shumë prej 50 (pesëdhjetë) euro si dhe shumën prej 30 (tridhjetë) euro për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë kanë paraqitur :

Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me propozimin që kolegji penal i Gjykatës së Apelit të ndryshojë sa i përket vendimit mbi dënimin dhe të iu shqiptojë dënim me gjobë në një shumë më të lartë si dhe dënim me burgim efektiv në kohëzgjatje më të lartë.

Përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarit M.S – av. I.R për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së kodit penal, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që

kolegji penal i Gjykatës së Apelit të e aprovojë në tërësi ankesën e të dëmtuarit dhe këtë çështje penale të e kthej në rigjykim dhe rivendosje apo të prishë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të njëjtin të e ndryshojë ashtu që dënimi i shqiptuar të akuzuarve të rritet dukshëm më shumë dhe të njëjtit me vendim penal të obligohen në kthimin e mjeteve financiare në shumën prej 150.000.00 franga zvicerane ndaj të dëmtuarit.

Mbrojtësi i të akuzuarit S.P – av. B.D për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që kolegji penal i Gjykatës së Apelit të aprovojë në tërësi si të bazuar ankesën dhe të ndryshojë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të akuzuarit S.P të i shqiptoj dënim më të butë.

Mbrojtësi i të akuzuarës M.S – av. B.M për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që kolegji penal i Gjykatës së Apelit të e aprovojë ankesën si të bazuar dhe aktgjykimin e ankimuar të e anuloj ndërsa çështjen të e kthej në gjykatës e shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan ka ushtruar mbrojtësi i të akuzuarit S.P – av. B.D, me propozim që kolegji penal i Gjykatës së Apelit të e refuzoj si të pabazuar ankesën e Prokurorit ndërsa të e aprovoj si të bazuar ankesën e paraqitur nga ana e tij ashtu që të e ndryshojë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të akuzuarit S.P të i shqiptoj dënim më të butë.

Prokuroria e Apelit e Kosovës, me parashtrësën PPA/II.nr.118/2023, datë 24.01.2023, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan si dhe pjesërisht ankesa e të dëmtuarit M.S vetëm sa i përket vendimit mbi dënimin ndërsa në pjesët e tjera ankesa e të dëmtuarit të hudhet si e palejuar, ashtu që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe ndaj të akuzuarve të shqiptohet një dënim më i ashpër, ndërsa të refuzohen ankesat e mbrojtësit të të akuzuarit S.P – av. B.D dhe mbrojtësit të të akuzuarës M.S – av. B.M si të pabazuara.

Gjykata e Apelit e Kosovës në kuptim të nenit 390 të KPPK-së caktoj dhe mbajti seancën e kolegjit për të cilën në kohë dhe në mënyrë të rregullt ishin njoftuar: Prokurori i Apelit, i akuzuari S.P dhe mbrojtësi i tij – av. B.D, e akuzuara M.S dhe mbrojtësi i saj – av. B.M, i dëmtuari M.S dhe përfaqësuesi i autorizuar i tij av. I.R. Në seancë prezantuan i akuzuari S.P dhe mbrojtësi i tij – av. B.D, e akuzuara M.S dhe mbrojtësi i saj – av. B.M, ndërsa Prokurori i Apelit, i dëmtuari M.S dhe përfaqësuesi i autorizuar i tij av. I.R, ndonëse të njoftuar me kohë dhe në mënyrë të rregullt nuk prezantuan në seancë para kolegjit penal të Gjykatës së Apelit. Mbrojtësi i të akuzuarit S.P – av. B.D deklaroi që mbetet pranë ankesës së ushtruar me shkrim, i mbrojturi i tij e ka pranuar fajësinë, dënimi i shqiptuar është i lartë dhe propozon që ankesa e tij të aprovohet si e bazuar ndërsa ankesa e prokurorit dhe e të dëmtuarit të refuzohen si të pabazuara. I akuzuari S.P deklaroi që e përkrah fjalën e avokatit dhe nuk ka çfarë të shtoj më tej. Mbrojtësi i të akuzuarës M.S – av. B.M deklaroi që mbetet pranë ankesës së ushtruar me shkrim dhe propozon që e njëjta të aprovohet ndërsa ankesa e Prokurorit dhe e të dëmtuarit të refuzohen si të pabazuara. E akuzuara M.S deklaroi që e përkrah fjalën e avokatit dhe nuk ka çfarë të shtoj më.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, pasi mbajti seancën e kolegjit, shqyrtoj shkresat e lëndës, vlerësoj pretendimet ankimore dhe analizoj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), konstatoj se :

- Ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan është e bazuar, ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit S.P – av. B.D dhe ankesa e mbrojtësit të të akuzuarës M.S – av. B.M janë të pabazuara, ndërsa ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të të dëmtuarit M.S – av. I.R është e palejuar.

Edhe pse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljeve të ligjit penal, megjithatë kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, duke u bazuar në nenin 394 paragrafi 1 të KPP, sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar edhe në këto drejtime dhe konstatoj se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e as shkelje të ligjit penal në dëm të të akuzuarve, të cilat do e kishin e kushtëzuar anulimin e tij.

Po ashtu as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj gjykate, ngase në ankesë nuk ka mundur të kontestohet, sepse të akuzuarit në shqyrtimin gjyqësor e kanë pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës, edhe gjykata është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj sipas nenit 383 par. 2 të KPPK-së, ndaj aktgjykimit që është marrë në bazë të pranimi të fajësisë ose marrëveshjes për pranimin e fajësisë nuk lejohet ankesa për gjendjen faktike, andaj aktgjykimi i ankimuar u vlerësua vetëm në frymën e pretendimeve ankimore sa i përket vendimit për dënim.

Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan në ankesë pretendon që gjykata nuk është dashur që të ulë dënimin deri në këtë masë sidomos kur kemi parasysh faktin se sipas nenit 70 par. 2 pika 2.2 dhe pika 2.8 të KPRK-së, shkalla e lartë e dashjes konsiderohet si rrethanë rënduese edhe pse gjykata e ka përmendur dashjen direkte por nuk e ka peshuar në mënyrë reale si dhe shkalla e dëmit të shkaktuar duke ia kërkuar të dëmtuarit shumën rreth 150.000 euro dhe atë në mënyrë të vazhdueshme e të cilat rrethana do të ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit përkundër se si rrethanë rënduese ka marrë këmbëngulësinë e shfaqur nga ana e tyre për kryerjen e veprës penale por nuk është vlerësuar nga se me veprimet e të akuzuarve e kanë dëmtuar nderin dhe autoritetin e të dëmtuarit të cilin e kanë detyruar që të kryejë një veprim në dëm të pasurisë së tij që si duket vetëm janë përmendur dhe nuk janë vlerësuar dhe kanë ndikuar në përcaktimin e dënimit, sidomos kur kemi parasysh mënyrën e kryerjes së veprës penale, faktin se të akuzuarit në vazhdimësi kanë kryer veprime të kundërligjshme me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vete duke mos marrë parasysh gjendjen dhe moshën e të dëmtuarit, faktin se përveç dëmit pasuror kanë shkaktuar edhe dëm moral dhe me dënimin e shqiptuar nuk do të arrihet qëllimi i dënimit, prandaj i ka propozuar kolegjit penal të Gjykatës së Apelit si në propozimin e lartëcekur.

Mbrojtësi i të akuzuarit S.P – av. B.D në ankesë pretendon që duke marrë parasysh rrethanat lehtësuese që gjykata e shkallës së parë ka gjetur për të mbrojturin e tij, dënimi i shqiptuar është tejet i ashpër dhe jo adekuat me të cilin do të arrihen qëllimet e parapara me nenin 38të KPRK-së dhe gjykata me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit nuk i ka zbatuar rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit, zbutjen dhe ashpërsimin e dënimit të parapara me nenin 69, 70, 71 të KPRK-së si dhe dispozitat për kufijtë e zbutjes së dënimit të parapara me

nenin 72 të KPRK-së, prandaj i ka propozuar kolegjit penal të Gjykatës së Apelit si në propozimin e lartëcekur.

Mbrojtësi i të akuzuarës M.S – av. B.M në ankesë pretendon që gjykata me rastin e marrjes së vendimit ka bërë shkelje sa i përket lartësisë së dënimit pasi që dënimi i shqiptuar nuk përkon me veprën penale dhe të akuzuarën, gjykata nuk ka bërë drejtë dhe saktë aplikimin e dispozitave sa i përket zbutjes së dënimit që parashihen në KPPK-së, gjykata nuk është lëshuar fare në nenin 69 dhe 70 par. 3 nënpar. 3.3, 3.10, 3.11 dhe 3.12 të KPRK-së, nuk e ka bërë matjen e saktë të shkallës së përgjegjësisë penale, nuk i ka dhënë fare rëndësinë e duhur deklarimit të të akuzuarës që nga fillimi i procedurës s dhe përgjegjësinë penale të saj në këtë rast, nuk ka bërë vlerësimin e saktë të rrethanave personale dhe karakterit të së akuzuarës siç parashihet në nenin 70 par. 3 nënpar. 3.3 të KPRK-së, ku e akuzuara është deklaruar se është nënë e tre fëmijëve të mitur pa përkujdesje nga askush, po ashtu gjykata nuk ka vlerësuar saktë kur ka marrë vendimin e atakuar dispozitat e nenit 70 par. 3 nënpar. 3.10, 3.11 dhe 3.12 nga se për të gjitha këto rrethana ka bazë që të vlerësohen saktë dhe drejtë dhe të njëjtat do të mund të merreshin parasysh me rastin e marrjes së këtij aktgjykimi për një dënim më të butë dhe më të favorshëm për të akuzuarën, prandaj i ka propozuar kolegjit penal të Gjykatës së Apelit si në propozimin e lartëcekur.

Sipas vlerësimit të kolegjit penal të Gjykatës së Apelit të Kosovës, pretendimet ankimore të paraqitura në ankesën e Prokurorit për shqiptimin e një dënimi më të rëndë janë të bazuara ndërsa pretendimet e mbrojtësve për shqiptimin e një dënimi më të butë janë të pabazuara. Kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë drejtë i ka konstatuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, mirëpo sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate rrethanat lehtësuese i ka mbivlerësuar ndërsa ato rënduese vetëm i ka konstatuar por se të njëjtat nuk i ka vlerësuar në mënyrë meritore, andaj tani kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se përgjegjësia penale e të akuzuarve është më e lartë se sa siç e ka vlerësuar gjykata e shkallës së parë dhe tani të akuzuarve iu shqiptoj dënime më të ashpra si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Kështu, gjykata e shkallës së parë me rastin e matjes së dënimit ndaj të akuzuarve S.P dhe M.S, e duke u bazuar në nenet 69 dhe 70 të KPRK-së, kishte marrë për bazë për të akuzuarin S.P si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë nga ana e tij meqenëse i njëjti fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale e ka bërë në shqyrtimin gjyqësor, pendimin e tij të cilin gjykata e mori si pendim real, keqardhjen e shfaqur nga ana e të akuzuarit, premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra të tilla dhe as vepra tjera penale, ndërsa për të akuzuarën M.S gjykata si rrethanë lehtësuese mori për bazë pranimin e fajësisë nga ana e saj meqenëse e njëjta fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale e ka bërë në shqyrtimin gjyqësor, pendimin e saj të cilin gjykata e mori si pendim real, keqardhjen e shfaqur nga ana e të akuzuarës, premtimin e saj se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra të tilla dhe as vepra tjera penale, ndërsa rrethanë rënduese për të akuzuarit gjykata mori shkallën e lartë të dashjes të shfaqur nga ana e tyre sepse nga përshkrimi faktik si dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës del se të akuzuarit këtë vepër penale e kanë kryer me dashje dhe atë direkte sepse të njëjtit e kanë ditur se me veprimet e tyre do të shkaktohet pasoja e ndaluar dhe përkundër kësaj të njëjtit kanë dëshiruar përkatësisht kanë ndërmarrë veprime për shkaktimin e pasojës së ndaluar ashtu siç përshkruhet si më lartë. Si rrethanë rënduese për të akuzuarit gjykata mori edhe këmbëngulësinë e shfaqur nga ana e tyre

për kryerjen e veprës penale sepse siç shihet nga përshkrimi faktik si në dispozitiv të aktgjykimit po ashtu edhe nga provat e çështjes del se të njëjtit kanë qenë të vendosur për të kryer veprën penale shantazhi nga neni 329 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, të cilët me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo personin tjetër, e duke e kanosur të dëmtuarin M.S se do të zbulojnë video-incizimin me veprime të ndryshme intime seksuale në lidhje me të si dhe ti dëmtojnë nderin apo autoritetin e tij, e kanë detyruar të njëjtin që herë pas here të kryej veprim në dëm të pasurisë së tij. Prandaj, duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat e lartcekura gjykata e shkallës së parë i shqiptoi të akuzuarit dënimin sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar me bindjen se edhe me një dënim të tillë do arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 38 të KPRK-së. Një konstatim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka konstatuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, mirëpo sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate rrethanat lehtësuese për të akuzuarit i ka mbivlerësuar ndërsa ato rënduese nuk i ka vlerësuar në mënyrë meritore, posaçërisht nuk e ka vlerësuar në mënyrë meritore dashjen direkte të të akuzuarve si dhe këmbëngulësinë e tyre për kryerjen e veprës penale, faktin se të dëmtuarin në një periudhë të gjatë kohore, afërsisht dy vite e kanë shantazhuar, duke e kanosur të njëjtin me qëllim që të e detyrojnë që i njëjti të kryejë veprime në dëm të pasurisë së tij, vlerën e lartë të dëmit, moshën e të dëmtuarit (73 vjeçar), prandaj duke pas parasysh të gjitha rrethanat që i ka konstatuar drejtë gjykata e shkallës së parë si dhe nga të lartëcekurat, si dhe duke pas parasysh faktin se në ankesat e mbrojtësve nuk theksohet ndonjë rrethanë e re veçanërisht lehtësuese e cila nuk është vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë dhe e cila do të kishte me pas ndikim në shqiptimin e një dënimi më të butë ndaj të akuzuarve, sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi si dhe dënimet e shqiptuara ndaj të akuzuarve janë në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarve si ekzekutorë dhe se kjo do t'i shërbej preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë, si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve, se me këtë kryerësit do të parandalohen nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të bëhet rehabilitimi i tyre. Andaj kolegji penal i kësaj gjykate konsideron se dënimi i shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi është i nevojshëm për tu arritur qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 38 të KPRK-së.

Duke shqyrtuar çështjen përkitazi me pretendimet ankimore për të cilat është ushtruar ankesa, sipas detyrës zyrtare Gjykata e Apelit konstaton se ankesa e përfaqësuesit të të dëmtuarit në rastin konkret është e palejuar. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, vepra penale për të cilën janë shpallur fajtor të akuzuarit, nuk hynë në kategorinë e veprave penale ku lejohet ankesa e të dëmtuarit, sepse sipas dispozitës së nenit 381 par. 3 të KPPK-së parashihet se: *“I dëmtuari ose viktimi mund të ushtrojë ankesë ndaj aktgjykimit vetëm për vendimin e gjykatës lidhur me sanksionet penale për trafikimin me qenie njerëzore, dhunën në familje, veprat penale kundër jetës dhe trupit, kundër integritetit seksual, kundër sigurisë së trafikut publik dhe për kërkesën pasurore juridike kur i akuzuari shpallet fajtor si dhe për shpenzimet e procedurës penale që ndërliken me të”*.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit vlerëson se ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të të dëmtuarit M.S – av. I.R, konform nenit 400 të KPPK-së është e palejuar, ngase të dëmtuarit nuk i lejohet ushtrimi i ankesës për veprën penale Shantazhi nga neni 329 par. 2 lidhur me par. 1 dhe nenin 31 të KPRK-së, e cila vepër është e përfshirë në kapitullin e XXVI – Veprat Penale Kundër Pasurisë. Pra, sipas vlerësimit të kësaj gjykate, ankesa e përfaqësuesit të dëmtuarit në rastin konkret është e palejuar, ngase vepra penale për të cilën janë shpallur fajtor të akuzuarit, nuk hyn në kategorinë e veprave penale për të cilat i dëmtuari ka të drejtë ankese.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart dhe në bazë të nenit 400 dhe 403 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Departamenti i Përgjithshëm
PA1.nr.76/2023, më datë 23.02.2023

Praktikantja gjyqësore
Anila Haklaj

Kryetari i kolegjit
Abdullah Ahmeti

Anëtarët e kolegjit:
Ferit Osmani

Zyhdi Haziri